

të të gjithëve prokurorëve në detyrë, znj.Gashi iu nënshtrua deklaramit të pasurisë dhe u shkarkua më pas nga detyra në vitin 2018, për shkak të dështimit për të kaluar vlerësimin e integritetit financiar. Ajo apeloj vendimin, por ankimi i saj u hodh poshtë me vendim përfundimtar në maj 2019. Ndërkohë, znj.Gashi ishte pezulluar nga detyra në përputhje me legjislacionin perkatës.

Kërkuesi i dytë, z.Gina ai iu nënshtrua procesit të vettingut në 2020-2021.

Në vitin 2018, pas disa shkrimeve në media, filloi një hetim penal për akuzat kundër kërkuesve në lidhje me mos zbulimin, fshehjen ose deklarimin e rremë të pasurisë në lidhje me Deklaratën e Pasurisë së znj.Gashi. Kërkuesit u pezulluan nga detyra në maj të atij viti, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ankesa kundër atij vendimi u shqyrtua përfundimisht nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila shfuqizoi pezullimin në nëntor 2018. Megjithatë, Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm paraqiti një rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili është ende në pritje të gjykimit, dhe kërkuesit nuk u rikthyen menjëherë në detyrë.

Procedimi penal u ndërpre me një vendim përfundimtar të marrë në prill 2019. Megjithatë, z. Gina u rikthye në detyrë në janar 2020.

Nga viti 2018, u publikuan në media disa artikuj mbi çështjen e kërkuesve, të cilat pretendohet se janë bazuar në dokumente të zbuluara pa lejen e kërkuesve dhe që ishin dhënë nga znj. Gashi në kuadër të procedurës së vettingut. Pretendimi u refuzua nga organet e vettingut, të cilat hetuan mbi pretendimet e kërkueses, pasi dokumentet e publikuara në media nuk ishin midis dokumenteve të depozituara nga kërkuesja e parë pranë KPK-së.

Duke u mbështetur në nenet 6 (e drejta për proces të rregullt ligjor), 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), dhe 13 (e drejta për një mjet efektiv ankimi), kërkuesit u ankuan, në veçanti, se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ishte një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, që pezullimi nga detyra përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tyre për respektimin e jetës private. Ata u ankuan gjithashtu për dokumentet që supozohet se janë zbuluar në media dhe për mungesën e mjeteve juridike efektive për kërkesën e tyre sipas nenit 8 të Konventës. Kërkesa u depozitua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 26 qershor 2018.

- *Gjetjet e Gjykatës Evropiane*

Lidhur me pretendimet për nenin 6 të Konventës: Gjykata i shpalli të papranueshme kërkesat e ankuesve sipas nenit 6 të Konventës, duke vënë në dukje, në veçanti, se procedurat para Kolegjit të Posaçëm të Apelit kishin të bënin vetëm me një çështje juridiksioni dhe se kërkuesit më pas kishin ushtruar me sukses të drejtën e tyre të aksesit në gjykatë, përpara një gjykate administrative (paragrafët 40-44 të vendimit).

Lidhur me pretendimet për nenin 8 të Konventës:

Sa i përket pezullimit nga detyra: Gjykata vuri në dukje se në maj 2018, Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm kishte lëshuar urdhra pezullimi për kërkuesit, duke i ndaluar ata në mënyrë të menjëhershme të ushtronin detyrat e tyre zyrtare si prokurorë. Urdhrrat mbështeteshin në faktin se ndaj tyre ishte në proces një hetim penal për një "krim të rëndë të kryer me dashje", dhe për faktin se ndaj tyre ishin ngritur akuza. Pezullimi ishte i detyrueshëm sapo një magjistrat merri statusin e të pandehurit në një hetim penal për veprën penale përkatëse dhe vijonte deri në përfundimin e procesit penal apo me shpalljen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Lidhur me znj.Gashi, Gjykata vendosi se ankesa e saj në lidhje me pezullimin nga detyra nuk përfshihet brenda qëllimit të nenit 8, pasi kërkesja e parë nuk ka demonstruar se pasojat negative si rezultat i urdhrin të pezullimit (i cili kishte qenë në fuqi për pak më shumë se dy muaj, gjatë të cilëve ajo vazhdoi të merrte pagën e saj) ishin mjaftueshëm të rënda për të vënë në rrezik të drejtën e saj për respektimin e jetës private, sipas nenit 8 të Konventës. Çdo ndikim tjetër negativ, për shembull në reputacion, kryesisht erdhi si pasojë e faktit se ajo ishte akuzuar për një vepër penale më shumë sesa nga pezullimi *ex lege*. Rrjedhimisht, ankesa e saj është e papranueshme *ratione materiae* dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 4 (paragrafët 56-58 të vendimit).

Megjithatë, Gjykata krijoi bindjen se pasojat për z. Gina - duke përfshirë paaftësinë për të punuar për 20 muaj, dhe pasigurinë e situatës së tij gjatë asaj periudhe, pavarësisht se ka vazhduar të marrë pagën e tij - kishin qenë mjaftueshëm serioze për të shkaktuar zbatimin e nenit 8 (paragrafët 61 dhe 64 të vendimit). Ky pezullim sipas vlerësimit të Gjykatës përbënte një "ndërhyrje" në jetën e tij private pasi nuk kishte qenë i mbështetur në ligj, pasi hetimi penal kundër tij kishte përfunduar. Si rrjedhojë, Gjykata gjeti një shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me pezullimin e z.Gina nga detyra.

Sa i përket ankesës për bërjen publike të dokumenteve në media: Gjykata konsideroi, në veçanti, se duke qenë se në pretendimet e kërkesve nuk ka ndonjë informacion sensitiv të ndjeshëm financiar që mund t'i kishin dëmtuar, këto kërkesa janë të papranueshme. Lidhur me raportimet e mëvonshme të mediave, ankesat nuk kishin paraqitur në detaje ose të ishin vërtetuar në formularin e aplikimit të tyre, dhe një pjesë e ankesës ishte paraqitur jashtë afatit dhe prandaj ishin të papranueshme.

Pretendime të tjera lidhur me nenin 13 të Konventës: Gjykata rrëzoi si të papranueshme dhe pretendimet e kërkesve lidhur me nenin 13,18 dhe 38 të Konventës duke u shprehur se nuk ishte e nevojshme t'i ekzaminonte ato.

Në kuadër të nenit 41 të Konventës ajo i akordoi kërkesit të dytë 4500 euro për dëmin jopasuror dhe 3000 euro për kostot dhe shpenzime.

Bazuar në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 (ndryshuar me ligjin Nr. 86/2018), në nenin 19/2, pika 3 të tij parashikohet, se Avokatura e Shtetit përcjell pranë institucioneve, për efekt të zbatimit të njehsuar të praktikës gjyqësore, vendimet e GJEDNJ-së për Shqipërinë, në gjuhën shqipe dhe atë origjinale.

Në këtë kontekst, lutemi gjeni bashkëlidhur vendimin, "Gashi dhe Gina k. Shqipërisë", kërkesa nr.29943/18, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Në kuadër të nenit 46 të Konventës që parashikon detyrimin e palëve për të marrë masa individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, lutemi të mbahet në konsideratë publikimi i vendimit në faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës dhe përfshirjen e tij në kurrikulat e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës, lidhur me respektimin e nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOCKA

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHITJA GASHI DHE GINA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 29943/18)

VENDIM

Neni 8 – Jeta private – Pezullimi i vazhduar nga detyra i prokurorit pas përfundimit të procesit penal ndaj tij në lidhje me deklarinimin e pasurisë, pa pasur baza ligjore

STRASBURG

4 prill 2023

Ky vendim është përfundimtar sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *kryetar,*

Georgios A. Serghides,

Yonko Grozev,

Darian Pavli,

Peeter Roosma,

Ioannis Ktistakis,

Andreas Zünd, *gjyqtarë,*

dhe Milan Blaško, *regjistrar i Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 29943/18) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë në mbështetje të Nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga dy shtetas shqiptarë, znj. Roven Gashi (“kërkuesja e parë”) dhe z. Dritan Gina (“kërkuesi i dytë”), më 26 qershor 2018;

vendimin e datës 7 shtator për të bërë me dije Qeverinë shqiptare (“Qeveria”) për ankesat në mbështetje të neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës, si edhe për dhënien e përparësisë në mbështetje të Rregullit 41 të Rregullores së Gjykatës;

komentet e palës së treta nga Res Publica, që kishte marrë lejen e kryetarit të Seksionit për të ndërhyrë në procedurën me shkrim (neni 36 § 2 i Konventës dhe Rregulli 44 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 7 mars 2023;

Jep vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me pezullimin e kërkuesve nga pozicionet e tyre si prokurorë publikë, pretendimet për të meta në proceset përkatëse dhe me mungesën e mjeteve efektive, dhe pretendimin për bërjen publike të dokumenteve për medien.

FAKTET

2. Kërkuesit kanë lindur në vitin 1977 dhe 1976, respektivisht, dhe jetojnë në Tiranë. Ata u përfaqësuan nga z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë që e ushtrojnë profesionin në Romë.

3. Fillimisht Qeveria u përfaqësua nga Agjenti i saj z. A. Metani, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbliidhen si më poshtë.

I. INFORMACION MBI KUADRIN E PËRGJITHSHËM

5. Në periudhën përkatëse, kërkuesit, një çift i martuar, punonin si prokurorë. Në vitin 2013, kërkuesja e parë u ngrit në detyrë në rolin e prokurores në Prokurorinë e Përgjithshme. Më pas, ajo u emërua drejtore e Njesisë së Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe punoi, *inter alia*, për çështje të profilit të lartë ku përfshiheshin politikanë, biznesmenë dhe deputetë. Si drejtore e Njesisë së Dekriminalizimit deri në fund të muajit dhjetor 2017, ajo mbikëqyri procedurat e prokurorisë për largimin e individëve me rekorde kriminale nga pozicionet publike sipas legjislacionit përkatës. Në atë cilësi, ajo pati sukses me kërkesat e saj drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ndërprerjen e mandatit të një sërë deputetësh, kryetarësh bashkish, dhe zyrtarëve të tjerë publikë. Kërkuesi i dytë, prej muajit janar 2018, ishte i punësuar si prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë (në vijim “prokuroria e Tiranës”).

6. Në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, i cili hyri në fuqi në vitin 2003, kërkuesit paraqitën deklaratimet vjetore të pasurisë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (“ILDKPKI”). Në vitin 2016, Shqipëria ndërmori reforma të thella në sistemin e drejtësisë, të cilat sollën ndryshime në Kushtetutë dhe miratimin e një sërë statutesh në lidhje me, midis të tjerash, rivlerësimin e të gjithë prokurorëve në detyrë (në vijim “procesi i rivlerësimit/*vetting*-ut”) nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”) në shkallën e parë dhe – në rastet e apelimeve – nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (“KPA”) pranë Gjykatës Kushtetuese (shih *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 4–7, 9 shkurt 2021).

7. Si pjesë e procesit të *vetting*-ut, kërkuesja e parë paraqiti një deklaratim të ri dhe të detajuar për pasurinë në muajin janar 2017. Në këtë deklaratim përfshiheshin pasuritë në pronësi të bashkëshortit të saj dhe të familjarëve të tjerë. ILDKPKI-ja, që ndihmon organet e *vetting*-ut gjatë procesit të *vetting*-ut, dha një vlerësim negativ për deklaratimin e saj të pasurisë. Më 6 mars 2018, ajo depozitoi përgjigjet për pyetësonin vijues të KPK-së për burimet e disa pasurive. Më anë të një vendimi të datës 25 korrik 2018, KPK-ja e shkarkoi kërkuesen nga detyra. Më 27 shtator 2018, ajo apeloj pranë KPA-së. Ajo u pezullua *ex lege* nga detyrat e saj në pritje të vendimit në shkallë apeli (shih paragrafët 17 dhe 21 më poshtë). Më 29 maj 2019, KPA-ja la në fuqi vendimin e KPK-së të datës 25 korrik 2018.

8. Për një periudhë tranzitore, KPA-ja veproi si gjykata e shkallës së fundit në çështjet disiplinore ku përfshiheshin gjyqtarë, prokurorë dhe zyrtarë të tjerë të drejtësisë (shih paragrafin 20 më poshtë).

9. Kërkuesi i dytë iu nënshtrua procesit të *vetting*-ut në vitet 2020 dhe 2021.

II. HETIMI PENAL DHE PEZULLIMI NGA DETYRA

10. Në muajin prill 2018, pas disa pretendimeve të ngritura në disa media *online* në muajin mars 2018, ndaj kërkuesve nisi një hetim penal në mbështetje të nenit 257/a § 2 të Kodit Penal (refuzim për deklaratim, mosdeklaratim, fshehje ose deklaratim i rremë i pasurisë), në lidhje me deklaratimet e bëra në deklaratimet periodike të pasurisë dhe gjatë procesit të *vetting*-ut në atë periudhë për sa i përket kërkueses së parë. Në datën 8 maj 2018, ndaj kërkuesve u ngritën akuza.

11. Në mbështetje të urdhrave të datës 11 maj 2018, sipas nenit 151 të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (shih paragrafin 25 më poshtë), Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm i pezulloi kërkuesit nga detyra gjatë procesit penal ndaj tyre. Në urdhrat e pezullimit specifikohesh se ata mund të apeloreshin në KPA, sipas nenit 179 § 7 të Kushtetutës (shih paragrafin 20 më poshtë). Kërkuesit iu drejtuan KPA-së, ku u informuan se KPA-ja nuk mund të merrte një vendim ndaj apelit të tyre, sepse një anëtar (I.R.) ishte tërhequr për konflikt interesi dhe, për shkak të mungesës

së një rregullimi specifik në atë periudhë, nuk mund të emërohej një zëvendësues. Më 21 qershor 2018, trupa gjyquese e KPA-së, duke përfshirë edhe I.R., nuk e shqyrtoi apelimin, duke u shprehur se ishte me vend që urdhrat e pezullimit të shqyrtoheshin pranë Gjykatës Administrative të Apelit, si gjykata kompetente për t'i gjykuar apelimet konkrete në shkallën e parë. Kërkuesit e dorëzuan këtë kërkesë pranë Gjykatës më 26 qershor 2018.

12. Më pas kërkuesit paraqitën një kërkesë pranë Gjykatës Administrative të Apelit duke kërkuar prishjen e urdhrave të pezullimit. Me anë të një vendimi të ndërmjetëm, gjykata e rrëzoi kërkesën e tyre për pezullimin e ekzekutimit të urdhrave të pezullimit. Me anë të një vendimi të datës 8 nëntor 2018, ajo i pranoi pretendimet e tyre, i deklaroi urdhrat e pezullimit të paligjshëm dhe i shfuqizoi ata. Ajo gjykoi se vepra për të cilën akuzoheshin kërkuesit – një vepër që dënohej me gjobë ose me burgim deri në tre vjet – ishte në kompetencën e një gjykate rrethi ku mund të gjykohej me një gjyqtar të vetëm, në vend që të gjykohej nga Gjykata për Krime të Rënda. Duke pasur në konsideratë nenin 2 të Konventës së Kombeve të Bashkuara ndaj Krimit të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000, “krim i rëndë” ishte një sjellje që përbënte një vepër të dënueshme me privim të lirisë maksimumi të paktën katër vjet, ose një dënim më i rëndë. Sipas neneve 1, 29, 31 dhe 32 të Kodit Penal, dhe neneve 13 dhe 75/a të Kodit të Procedurës Penale, krimet e rënda ishin ato që sipas legjislacionit i atribuoheshin kompetencës së Gjykatës për Krimet e Rënda, Antikorrupsion dhe Krimit të Organizuar, ose krime të tjerë në kompetencën e një gjykate rrethi që dënoheshin me burgim deri në dhjetë vjet. Për rrjedhojë, neni 151 i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve që parashikonte një pezullim *ex lege* nuk ishte i zbatueshëm në rastin e kërkuesve. Gjykata rrëzoi urdhrat për pezullim të Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm të datës 11 maj 2018, dhe urdhëroi Prokurorinë e Përgjithshme të paguante kostot e kërkuesve. Vendimi i datës 8 nëntor 2018 nuk specifikonte nëse vendimi hynte menjëherë në fuqi. Sipas kërkuesve, vendimi hynte në fuqi menjëherë (shih edhe paragrafët 14 dhe 16 më poshtë), edhe pse ai mund të apelohej në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë. Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm i kërkoi Gjykatës së Lartë të shqyrtoheshin pikat e ligjit. Rezulton që ky apelim të mos jetë shqyrtuar ende. Në janar 2019, Gjykata Administrative e Apelit shpalli një vendim shtesë ku specifikonte shumën e kostove që duhej t'u paguhej kërkuesve.

13. Prokuroria e Rrethit Fier mori përsipër hetimin penal nga një prokurori tjetër dhe kërkoi ndërprerjen e tij. Me anë të një vendimi të datës 4 shkurt 2019, Gjykata e Rrethit Fier e pranoi kërkesën. Ajo gjykoi se vlerësimi i ILDKPKI-së për deklarimin e kërkuesit të parë për *vetting*-un kishte qenë një masë paraprake specifike për procesin e *vetting*-ut dhe që i nënshtrohej vlerësimit të organeve të *vetting*-ut. Raporti nuk mund të përdorej në asnjë proces tjetër ndaj personit që rivlerësohej. Ky i fundit nuk mund t'i nënshtrohej ndonjë procedure tjetër në lidhje me faktet përkatëse teksa procesi i *vetting*-ut ishte ende pezull. Procesi penal u pushua në mbështetje të nenit 328 § 1 (d) dhe (f) të Kodit të Procedurës Penale (vendoset pushimi i çështjes kur ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë, si edhe në rastet e tjera të parashikuara me ligj). Më 18 prill 2019, Gjykata e Apelit Vlorë la në fuqi vendimin e datës 4 shkurt 2019.

14. Më 20 mars 2019, përmbaruesit depozituan pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në emër të kërkuesve, një njoftim për ekzekutim të vullnetshëm të vendimit për shlyerjen e kostove të kërkuesve, vendim i cili u shpall më 8 nëntor 2018. Më 11 prill 2019, procedura e ekzekutimit u ndërpre pasi kostot u paguan.

15. Më 16 prill 2019, kërkuesi i dytë i kërkoi prokurorisë Tiranë që t'i siguronte “kushtet fizike, infrastrukturën teknike dhe bazën materiale që të mund të vazhdonte me funksionet e tij në prokurori pranë prokurorisë së Tiranës”. Pas krijimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (organi drejtues për emërimin, shkarkimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe masat disiplinore për prokurorët – në vijim “KLP”) në dhjetor 2018, në muajin qershor 2019, prokuroria e Tiranës kërkoi

opinionin e KLP-së nëse duhej, apo si duhej, të ekzekutonte vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit të datës 8 nëntor 2018, për anulimin e urdhrin të pezullimit në lidhje me kërkuesin e dytë. Deri në tetor 2019 nuk u dha asnjë përgjigje. Sipas Qeverisë, kërkuesi i dytë nuk paraqiti ndonjë kërkesë pranë KLP-së apo Prokurorisë së Përgjithshme për ekzekutimin e vendimit.

16. Prokuroria e Tiranës vazhdoi t'i paguante kërkuesit të dytë pagën mujore gjatë gjithë periudhës së pezullimit të tij. Pas një shkrese dërguar nga Prokurori i Përgjithshëm i sapoemëruar, në janar 2020, kërkuesit i kërkohet të paraqitej në zyrë dhe të vazhdonte detyrat e tij si prokuror pa vonesë pas marrjes së shkresës.

17. Edhe kërkuesja e parë vazhdoi të merrte pagën e saj (shih paragrafin 27 më poshtë). Pasi ushtroi të drejtën e saj për të apeluar pranë KPA-së ndaj vendimit të KPK-së të datës 25 korrik 2018, gjatë procesit përkatës të apelimit, ajo u pezullua *ex lege* nga detyrat e saj në mbështetje të nenit 62(1) të Ligjit të Rivlerësimit. Më pas, ajo u shkarkua nga pozicioni i saj. Shkarkimi i saj hyri në fuqi pas vendimit të KPA-së të datës 29 maj 2019. Sipas së njëjtës dispozitë në Ligjin për Rivlerësimin dhe nenit F § 5 të Aneksit të Kushtetutës, ajo u pagua në masën 75% të pagës së saj gjatë pezullimit në mbështetje të parashikimeve në Ligin e *Vetting*-ut.

III. PRETENDIMI PËR BËRJEN PUBLIKE TË DOKUMENTEVE PËR MEDIEN

18. Më 9 mars 2018, Alpenews, një portal lajmesh *online*, publikoi artikullin e mëposhtëm:

“Thellohet skandali i ish-drejtuesve më të lartë Prokurorisë së Përgjithshme. Faktet dhe provat e investigimit të “Alpenews.al”, pas ish-kryeprokurorit të Shqipërisë A.L., të çojnë te bashkëpunëtorja e tij më e afërt [kërkuesja e parë].

Vetëm pak orë pasi ajo ka humbur procesin gjyqësor të ngritur kundër vendimit të Kryeprokurores së Përkohshme A.M., për shkarkimin nga detyra e Drejtoreshës së Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe asaj të Dekriminalizimit, dalin në dritë të dhëna që pritet ta tronditin nga themelet sistemin e vjetër të drejtësisë shqiptare...

Për disa javë me radhë, opinionin ynë publik është njohur me vendimin... që i ndaloi hyrjen në SHBA A.L. dhe familjarëve të tij, për shkak të përfshirjes së tij në raste të mëdha korrupsioni. Kjo u shoqërua me publikimin e provave dhe fakteve që tregonin jetën e shfrenuar të familjes së ish-kryeprokurorit të Shqipërisë, e cila i tejkalon frikshëm, mundësitë e kufizuara financiare që të ofrojnë dy pagat normale të dy zyrtarëve të shtetit shqiptar që janë edhe të ardhurat legale të deklaruara nga A.L. dhe bashkëshortja e tij.

Gjatë kësaj jave, Alpenews.al publikoi rezultatet e investigimit që zbuloi me dokumente zyrtare dhe shkresa me firmën e A.L. për përfshirjen e tij në një megaskemë të errët investimesh financiare në pasuri të paluajtshme, të blera me çmime qesharake e më pas të rishitura ose rivlerësuara, me çmime dhjetëra herë më të larta brenda një kohe fare të shkurtër. Një skemë e cila sipas ekspertëve të fushës është tipike e pastrimit të parave të pista.

Ndërkohe që zhvillohej ky investigim, provat dhe faktet na çuan me sa duket pashmangshmërisht te [personi] që është konsideruar gjithmonë si krahu i djathtë i A.L. dhe si bashkëpunëtorja e tij më e ngushtë në Prokurorinë e Përgjithshme [kërkuesja e parë]. Prova dhe fakte këto që zbulojnë një botë edhe më të errët se ajo e A.L. Duke na ofruar prova tronditëse për pasuritë e [kërkueses së parë] dhe familjarëve të saj.

Ajo është munduar që të aplikojë një skemë edhe më të sofistikuar për fshehjen e pasurive, sesa ajo që u zbulua për A.L. Për rrjedhojë edhe zbulimi i Alpenews.al është edhe më i rëndë. Një zbulim që pritet të tronditi jo vetëm pozitat juridike të [kërkueses së parë], por ndoshta të krejt sistemit të vjetër të drejtësisë. Prova këto që do të bëhen publike nga ne në orët dhe ditët në vijim.”

19. Artikuj të tjerë, mbi dyzet artikuj sipas kërkuesve, u publikuan në periudhën nga muaji mars deri më korrik 2018. Kërkuesja e parë u ankua pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit se një anëtar i trupës gjyqësore të KPK-së në çështjen e saj (S.Z.) ishte në pozitat e konfliktit të interesit, sepse një i afërm (i kërkueses së parë) kishte depozituar një padi penale ndaj bashkëshortit të S.Z.

për një vepër të rëndë, për të cilën ai po gjykohej. Kërkuesja e parë pretendoi se S.Z. mund të ketë bërë publike informacione konfidenciale për Alpenews dhe kërkoi që kjo rrjedhje informacioni të hetohej. Në ankesën e saj pranë OMN-së, kërkuesja e parë parashtrroi se Alpenews kishte bërë publike dokumente, në lidhje me çështje private të babait të saj (vendime nga Komisioni për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave; certifikatën e pronësisë për një sërë pronash; kontrata shitblerjesh për prona dhe pasuri të caktuara të dhëna me qira). Kryetari i KPK-së nisi një hetim, ku kërkoi shpjegime prej S.Z., një anëtar i tjetër të KPK-së dhe dy këshilltarëve. Sipas S.Z., dokumentet e publikuara në medie nuk ishin midis dokumenteve të depozituara nga kërkuesja e parë pranë KPK-së. Ajo nuk kishte dijeni për rrethanat e pretenduara nga kërkuesja e parë dhe deklaroi se edhe nëse ato rrethana ekzistonin, ato nuk do të përbënin konflikt interesi. Sidoqoftë, S.Z. shprehu vullnetin për t'u tërhequr nga trupa gjykuese e KPK-së për të shmangur ndonjë dëm për procesin e *vetting*-ut. Për shqyrtimin e kërkesës së S.Z. për t'u tërhequr nga trupa gjykuese u ngrit një panel. Më 15 mars 2018, paneli e pranoi kërkesën. Më 8 maj 2018, OMN-ja refuzoi të merrte masa disiplinore ndaj S.Z. sipas nenit 17 të Ligjit të Rivlerësimin (shih paragrafin 23 më poshtë). Rezulton se kërkuesja e parë u ankua edhe pranë ILDKPKI-së, por nuk mori përgjigje.

PRAKTIKA DHE KUADRI LIGJOR PËRKATËS

I. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË

20. Në mbështetje të nenit 179 § 7 të Kushtetutës, së bashku me nenin 179/b, gjatë një mandati nëntëvjeçar, Kolegji i Posaçëm i Apelineve (“KPA”) ushtron juridiksion disiplinor ndaj të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (“KLP”), Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. KPA-ja shqyrtonte apelimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, KLP-së dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke vendosur masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve respektivisht (shih edhe paragrafin 28 më poshtë).

21. Neni F i aneksit të Kushtetutës parashikon se gjatë shqyrtimit të një apelimi në *vetting* nga KPA-ja, personi që rivlerësohet merr 75% të pagës së tij/saj; një vendim i formës së prerë që urdhëron shkarkimin nga detyra ka një efekt të menjëhershëm *ex lege*, dhe një person i cili është në procesin e rivlerësimit dhe që apelon masën disiplinore të shkarkimit, pezullohet nga detyra në pritje të vendimit të KPA-së. Në praktikë, personat në *vetting* janë konsideruar të pezulluar nga momenti i vendimit për shkarkim dhënë nga KPK-ja, duke pasur parasysh vonesat e mundshme në ofrimin e një vendimi të arsyetuar për subjektet e rivlerësuar.

22. Sipas nenit Ç të aneksit të Kushtetutës, barra e provës kalon te personi i rivlerësuar vetëm për procesin e *vetting*-ut, duke përjashtuar proceset e tjerë, veçanërisht, proceset penale.

II. LIGJI NR. 84/2016, PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE (“LIGJI I *VETTING*-ut”)

23. Sipas nenit 16, anëtarët e organeve të rivlerësimit mbajnë përgjegjësi disiplinore për, *inter alia*, shkeljen e detyrimit të konfidencialitetit dhe mospërhapjes së informacionit, që rezulton nga hetimi apo gjykimi, duke përfshirë publikimin dhe bërjen publike, edhe për shkak të neglizhencës, së vendimeve konfidenciale, informacioneve apo vendimeve procedurale, që rrjedhin nga çështjet që janë në proces hetimi ose gjykimi, si edhe për bërjen e deklaratave publike – duke përfshirë edhe në medie - për çështjet, me përjashtim të komunikimeve për shtyp brenda qëllimeve të detyrës së tyre. Sipas nenit 17, nëse ka të dhëna të mjaftueshme nga burime të besueshme se anëtar i institucioneve të rivlerësimit ka kryer një shkelje disiplinore ndaj tij fillon hetimi disiplinor, në mbështetje të kërkesës së një anëtar i tjetër në të njëjtin organ rivlerësimi, ose së kërkesës bërë nga një vëzhgues ndërkombëtar ndaj një Komisioneri Publik, një Komisioneri ose anëtarëve të KPA-së.

24. Sipas nenit 28, anëtarët e organeve të rivlerësimit dhe personeli i tyre duhet të trajtojnë të gjithë informacionin në lidhje me procesin e rivlerësimit në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Organet e rivlerësimit përjashtohen nga ky detyrim vetëm në

rastet kur informacioni i jepet subjektit të rivlerësimit ose organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës së tyre zyrtare.

III. LIGJI NR. 96/2016, LIGJI PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

25. Sipas nenit 151, nën emërtimin “Pezullimi i detyruar”, një magjistrat (gjyqtar ose prokuror) pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës nëse, *inter alia*, ai merr statusin e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje. Pezullimi zgjat deri në pushimin e procesit penal ose me dhënien e një vendimi të formës së prerë.

26. Sipas nenit 155, një magjistrat (gjyqtar ose prokuror) ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në gjykatën kompetente; një ankim i tillë nuk pezullon vendimin për pezullimin nga detyra të magjistratit.

27. Sipas nenit 157, një magjistrat përfiton pagë të plotë gjatë pezullimit, përveç rasteve specifike. Veçanërisht, nëse magjistrati dënohet për kryerjen e një vepre penale nga gjykata e shkallës së parë ose jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli kompetent, Këshilli mund të pezullojë përfitimin e pagës deri në 50 për qind, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa të vendoset mbi çdo ankim të paraqitur në një gjykatë më të lartë. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në favor të magjistratit, çdo shumë e mbajtur i kthehet menjëherë magjistratit. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në disfavor të magjistratit, shumat e mbajtura vazhdojnë të mbahen derisa çështja penale ose disiplinore, për të cilën është vendosur pezullimi i përfitimit, të përfundojë me vendim të formës së prerë.

28. Sipas nenit 160, deri në krijimin e KLP-së, Prokurori i Përgjithshëm duhet të vijojë të ushtrojë kompetencat e Këshillit sipas Ligjit, duke përfshirë pezullimin e prokurorëve.

IV. LIGJI NR. 115/2016, PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

29. Sipas nenit 192(1), ndryshuar në vitin 2019, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese (shih edhe paragrafin 20 më sipër).

LIGJI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË SË DREJTËS PËR TË BËRË NJË KËRKESË

30. Qeveria argumentoi se kërkuesit kishin abuzuar me të drejtën e tyre për të bërë një kërkesë, sepse ata nuk kishin informuar Gjykatën për vendimin e datës 8 nëntor 2018 dhe se kishin deklaruar se ILDKPKI-ja nuk kishte identifikuar problematika me deklaratimet e tyre periodike të pasurisë.

31. Kërkuesit kundërshtuan.

32. Një kërkesë mund të kundërshtohet për abuzim me të drejtën për të bërë një kërkesë nëse, *inter alia*, me vetëdije, ajo mbështetet në fakte të pavërteta me qëllimin për të mashtruar Gjykatën (shih *X dhe të Tjerët kundër Bullgarisë* [DHM], nr. 22457/16, § 145, 2 shkurt 2021, dhe *G.I.E.M. S.R.L. dhe të Tjerët kundër Italisë* [DHM], nr. 1828/06 dhe 2 të tjerë, § 172, 28 qershor 2018). Dhënia e informacionit jo të plotë dhe mashtrues mund të sjellë edhe shkeljen e së drejtës për të paraqitur një kërkesë, veçanërisht nëse informacioni ka të bëjë me thelbin e çështjes dhe nëse nuk ofrohen shpjegime të mjaftueshme me qëllim që ky informacion të mos shpërndahet (shih *Gross kundër Zvicrës* [DHM], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014). I njëjti parashikim vlen edhe nëse gjatë procesit në Gjykatë ndodhin zhvillime të reja, dhe nëse, pavarësisht se parashikohet shprehimisht në Rregullin 47 § 7 të Rregullores së Gjykatës, kërkuesi nuk e paraqet informacionin përpara Gjykatës, duke e penguar Gjykatën që të gjykojë çështjen në dijeni të plotë të fakteve (shih *Mirolubovs dhe të Tjerë kundër Letonisë*, nr. 798/05, § 63, 15 shtator 2009, dhe *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë* [DHM], nr. 38433/09, § 97, GJEDNJ 2012). Edhe në të tilla raste, qëllimi i kërkuesit për të mashtruar Gjykatën duhet të provohet me siguri të mjaftueshme (shih *Centro Europa S.r.l. dhe Di Stefano*, § 97, dhe *Gross*, § 28, të dy cituar më sipër).

33. Në dhjetor 2018, kërkuesit informuan me përpikëri Gjykatën për vendimin e datës 8 nëntor 2018. Edhe nëse hamendësohet se çështjet në lidhje me deklaratimet periodike të pasurisë, edhe pse në një masë të kufizuar, mund të lidheshin me faktet thelbësore që kanë të bëjnë me qëllimin e çështjes në Gjykatë (shih paragrafët 34, 45, 72 dhe 80 më poshtë), nuk ka arsye të gjykohet se kërkuesit u përpoqën ta mashtronin apo keqinformonin atë. Gjykata nuk është penguar në gjykimin e çështjes në dëgjimin e plotë të fakteve. Për këtë arsye kundërshtimi i Qeverisë duhet të rrezohet.

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 TË KONVENTËS

34. Kërkuesit u ankuan se KPA-ja, e cila kishte refuzuar të shqyrtonte meritat e ankimit të tyre ndaj urdhrave të pezullimit, nuk kishte qenë një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Ata u mbështetën në nenin 6 të Konventës, pjesët përkatëse të së cilit parashikojnë si më poshtë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj..., e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”

A. Parashtrimet e palëve

1. Qeveria

35. Qeveria argumentoi se KPA-ja ishte një gjykatë e paanshme dhe e pavarur. Vendimi i datës 8 nëntor nga Gjykata Administrative e Apelit kishte qenë në favor të kërkuesve, duke i hequr ata nga statusi i viktimës përpara Gjykatës. Gjithashtu, Qeveria informoi Gjykatën se kërkuesi i dytë ishte rikthyer në detyrën e tij zyrtare në janar 2020.

2. Kërkuesit

36. Kërkuesit argumentuan se KPA-ja nuk kishte qenë një gjykatë e paanshme dhe e pavarur (shih, në të njëjtën linjë, *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 260-65, 9 shkurt 2021) dhe se trupa gjyquese për çështjen e tyre kishte qenë e paanshme, për shkak të përfshirjes së I.R në përbërje të trupës. Vendimi i datës 8 nëntor 2018 nuk kishte qenë i mjaftueshëm për t'i hequr nga statusi i tyre i viktimës sipas neneve 6 dhe 8 të Konventës. Përshtatshmëria dhe mjaftueshmëria e masës korrigjuese ishte në varësi të rrethanave specifike të çështjes, të tilla si natyra e së drejtës, arsyet dhënë për vendimin, shuma e kompensimit dhe vijueshmëria e rrethanave të pafavorshme për personin konkret pas atij vendimi. Ata ishin pezulluar për shkak të nisjes së një hetimi penal fals për mospërputhje në deklaratimet e tyre.

37. Kërkuesja e parë ishte e vetmja magjistrate në Shqipëri e cila kishte qenë subjekt i një procesi penal dhe ishte pezulluar nga pozicioni i saj zyrtar, teksa procesi i rivlerësimit ishte ende pezull. Në të gjitha çështjet e tjera, prokuroritë përkatëse kishin refuzuar nisjen e hetimeve penale, ndërsa procesi i rivlerësimit ishte në vijimësi. Pezullimi i saj kishte pasur një ndikim përçarës në procesin e rivlerësimit dhe kishte ndikuar ndjeshëm në vendimin e KPK-së, e cila i ishte referuar pezullimit dhe e kishte shkarkuar nga detyra mbështetur në të njëjtat fakte për të cilat ajo po hetohej, në të njëjtën kohë, në procesin penal. Vendimi i datës 8 nëntor 2018 ishte dhënë shumë vonë, sepse pas vendimit të KPK-së në korrik 2020, ajo ishte pezulluar *ex lege* në mbështetje të Ligjit të Rivlerësimit.

38. Në parashtrimet e kërkuesve depozituar në muajin prill 2019, kërkuesi i dytë argumentonte se teksa vendimi i datës 8 nëntor 2018 ishte i ekzekutueshëm në mënyrë të menjëhershme, autoritetet kompetente kishin refuzuar në mënyrë të paligjshme ta rikthenin në detyrë. Qeveria nuk kishte ofruar shpjegime për moszbatimin e atij vendimi. Kërkuesi i dytë nuk kishte përfituar nga ai vendim, që, në moszbatim, nuk kishte qenë masa korrigjuese efektive dhe e përshtatshme, sipas nenit 34 të Konventës. Për shkak të pezullimit të tij të vazhduar, ai ishte ndaluar të merrte pjesë në zgjedhjen e anëtarëve të KLP-së në muajin dhjetor 2018.

3. Ndërhyrja e palës së tretë

39. Parashtrimet e palës së tretë përmbledhen në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 276-79).

B. Vlerësimi i Gjykatës

40. Edhe nëse neni 6 § 1 i Konventës është i zbatueshëm për procedurat në të cilat prokurorët publikë kundërshtojnë pezullimet e tyre *ex lege* nga detyra (krahaso *Paluda kundër Sllovakisë*, nr. 33392/12, §§ 33–34, 23 maj 2017; *Camelia Bogdan kundër Rumanisë*, nr. 36889/18, § 70, 20 tetor 2020; *Loquifer kundër Belgjikës*, nr. 79089/13 dhe 2 të tjerë § 41, 20 korrik 2021; dhe *Juszczyżsyn kundër Polonisë*, nr. 35599/20, § 137, 6 tetor 2022), ankesat e kërkuessve në çështjen konkrete, në çdo rast, janë të papranueshme për arsyet e mëposhtme.

41. Në lidhje me ankesën e kërkuessve në Gjykatë në muajin qershor 2018 se iu ishte mohuar e drejta për t’iu drejtuar një gjykate përpara KPA-së, rezulton se çështja e tyre kishte mbetur e pashqyrtuar, sepse pezullimi sipas nenit 151 të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ishte jashtë kompetencës së KPA-së për proceset e zakonshme disiplinore. KPA-ja specifikoi se rruga e duhur për shqyrtim gjyqësor ishte Gjykata Administrative e Apelit. Në vijim kërkuessit e përdorën atë mundësi, dhe në nëntor 2018, çështja e tyre u shqyrtua për meritat e saj, duke ushtruar në këtë mënyrë të drejtën e tyre për t’iu drejtuar një gjykate. Gjithashtu, konstatohet se ata morën rezultatin që e konsideronin të ishte i kënaqshëm (krahaso *Antonyuk kundër Ruisë*, nr. 47721/10, § 105, 1 gusht 2013). Kështu, kjo ankesë është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

42. Për sa ka të bëjë me pavarësinë dhe paanshmërinë, së pari, në lidhje me argumentet që i përkasin KPA-së si institucion, Gjykata e ka trajtuar këtë çështje në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 309-16). Pas shqyrtimit të parashtrimeve të palëve në çështjen konkrete, Gjykata nuk konstaton asnjë arsye për t’u ndarë nga përfundimet në vendimin *Xboxhaj*. Në këtë mënyrë, kjo ankesë është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

43. Së dyti, në lidhje me argumentet që kanë të bëjnë me trupën e KPA-së për çështjen e kërkuessve, Gjykata konstaton se në rrethanat e çështjes konkrete, kërkuessit nuk vuajtën asnjë disavantazh të rëndë sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (b) të Konventës (shih *Kapustina kundër Ruisë* (vendim), nr. 56109/13, §§ 12 dhe 19–25, 7 qershor 2022, dhe *C.P. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 300/11. § 41, 6 shtator 2016). Procesi i kundërshtuar përpara trupës së KPA-së kishte të bënte me, dhe rezultoi në, përcaktimin e aspektit të juridiksionit. Pretendimi i kërkuessve, më pas, u shqyrtua nga një gjykatë tjetër, për të cilën nuk u ngrit asnjë çështje për “një gjykim të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”. Ata morën një rezultat të favorshëm për meritat e pretendimit të tyre. Gjithashtu, respektimi i të drejtave të njeriut sipas parashikimit në Konventë nuk kërkon një shqyrtim të kësaj ankese për meritat. Më herët, Gjykata ka shqyrtuar çështje të ngjashme, duke përfshirë kontekstin e përjashtimit të një gjyqtari (shih, midis autoriteteve të tjerë, *Alexandru Marian Iancu kundër Rumanisë*, nr. 60858/15, § 69, 4 shkurt 2020, dhe *Paixão Moreira Sá Fernandes kundër Portugalisë*, nr. 78108/14, §§ 90-94, 25 shkurt 2020). Ankesa e kërkuessve nuk ngre ndonjë çështje parimi apo ndonjë problem të ri ligjor, duke përfshirë problemet e natyrës strukturore (shih, në këtë aspekt, *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 309-16). Në këtë mënyrë, ajo duhet rrëzuar në përputhje me nenin 35 §§ 3 (b) dhe 4 të Konventës.

44. Duke marrë në konsideratë natyrën e ankesave, konkluzionet e mësipërme nuk ndikohen nga çështjet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e menjëhershëm të urdhrave të pezullimit ose me garantimin për zbatueshmërinë apo ekzekutimin e vendimit të datës 8 nëntor 2018. Gjithashtu, këto konkluzione nuk paragjykojnë vlerësimin e këtyre çështjeve për aq sa mund të kenë lidhje me ankesën sipas nenit 8 të Konventës (shih më poshtë).

III. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS PËR PEZULLIMIN NGA DETYRA

45. Kërkuessit u ankuan se pezullimi i tyre nga detyra në mbështetje të urdhrave të pezullimit të datës 11 maj 2018 kishte shkelur të drejtën e tyre për respektimin e jetës private. Ata u mbështetën në nenin 8 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

46. Qeveria i përsëriti parashtrimet e saj në mbështetje të nenit 6 të Konventës (shih paragrafin 35 më sipër), duke argumentuar si vijon. Kërkuesit u pezulluan *ex lege* pasi ndaj tyre nisi procesi penal. Sipas parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm, pezullimi duhej të zbatohet deri në përfundimin e procesit ose në shpalljen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Gjatë gjithë periudhës, ata vijuan të merrnin pagat e tyre. Kërkuesit kishin pasur mundësinë të kërkonin shqyrtim gjyqësor për urdhrat e pezullimit dhe kishin pasur sukses. Ata nuk e kishin më statusin e viktimës në mbështetje të nenit 8 të Konventës.

47. Kërkuesit i përsëritën parashtrimet e tyre në mbështetje të nenit 6 të Konventës (shih paragrafët 36–38 më sipër), duke argumentuar si vijon. Pezullimi i tyre i menjëhershëm nga detyra përbënte ndërhyrje në të drejtat e tyre në mbështetje të nenit 8 § 1 të Konventës, gjë e cila nuk kishte qenë “në përputhje me ligjin”, sipas interpretimit të nenit 8 § 2, siç konfirmohet nga vendimi i datës 8 nëntor 2018. Hetimi penal ndaj tyre ishte ndërprerë në mungesë të provave për ndonjë shkelje dhe, çfarë ishte më e rëndësishme, për faktin se asnjë hetim nuk mund të nisej ndaj një zyrtari që ishte subjekt i procesit të rivlerësimit. Reputacioni, nderi dhe karriera e tyre kishte pësuar një goditje të parikuperueshme edhe për shkak të fushatës së mediave të ndërmarrë ndaj tyre. Pezullimi kishte pasur një ndikim negativ në procesin e rivlerësimit të kërkueses së parë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parimet e përgjithshme

48. Parimet e përgjithshme në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 8 të mosmarrëveshjeve, në lidhje me punësimin janë përmbledhur nga Gjykata në vendimin *Denisov kundër Ukrainës* ([DHM], nr. 76639/11, 25 shtator 2018), si në vijim:

“115. ... mosmarrëveshjet në lidhje me punësimin nuk përjashtohen *per se* nga kuadri i ‘jetës private’ sipas interpretimit të nenit 8 të Konventës. Ka disa aspekte tipike të jetës private që mund të ndikohen në të tilla mosmarrëveshesh nga shkarkimi nga detyra, ulja në detyrë, mospranimi në një profesion apo nga masa të tjera po ashtu të pafavorshme. Këto aspekte përfshijnë: i: “rrethin e brendshëm” të kërkuesit; ii. mundësinë e kërkuesit për të vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerët; dhe iii. reputacionin social dhe profesional të kërkuesit. Ka dy mënyra në të cilat një problematikë e jetës private zakonisht do të çonte në një mosmarrëveshje të tillë: ose për shkak të arsyeve të brendshme për masën e kundërshtuar (në një rast të tillë Gjykata zbaton qasjen e mbështetur në arsye), ose – në raste të caktuara – për shkak të pasojave për jetën private (në këtë rast Gjykata zbaton qasjen e mbështetur në pasoja).

116. Nëse qasja e mbështetur në rrethana është në rrezik, pragu i nivelit të seriozitetit të çështjes në lidhje me aspektet e sipërpërmendur merr një rëndësi të madhe. I takon kërkuesit të provojë bindshëm se pragu është arritur në rastin e tij apo të saj. Kërkuesi duhet të paraqesë prova që vërtetojnë pasojat e masës së kundërshtuar. Gjykata do të pranojë se nenit 8 është i zbatueshëm vetëm në rastin kur këto pasoja janë shumë serioze dhe prekin jetën e tij ose të saj private në një nivel të lartë.

117. Gjykata ka përcaktuar kriteret për vlerësimin e rëndësisë apo seriozitetit të shkeljeve të pretenduara në kontekste të ndryshme rregullatorë. Vuajtja e një kërkuesi do të vlerësohet duke krahasuar jetën e tij apo të saj përpara dhe pas masës konkrete. Në vijim, Gjykata mban në

konsideratë faktin se në përcaktimin e seriozitetit të pasojave në çështjet që kanë të bëjnë me punësimin është me vend që të vlerësohen perceptimet subjektive të pretenduara nga kërkuesi ndaj kuadrit të rrethanave objektive që ekzistojnë në një çështje të caktuar. Kjo analizë do të duhet të trajtojë si ndikimin material edhe atë jomaterial të masës. Megjithatë, i takon kërkuesit që të përcaktojë dhe të vërtetojë natyrën dhe përmasën e vuajtjes së tij ose saj, e cila duhet të ketë një lidhje shkakësore me masën e kundërshtuar. Për sa i përket rregullit për shterimin e mjeteve vendëse, elementet thelbësore për pretendime të tilla duhet të ngrihen në mënyrë të mjaftueshme përpara autoriteteve vendëse që po trajtojnë çështjen.”

b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme për çështjen konkrete

49. Më 11 maj 2018, Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm lëshoi urdhrat e pezullimit për kërkuesit, duke i ndaluar ata në mënyrë të menjëhershme të ushtronin detyrat e tyre zyrtare si prokurorë (krahaso në lidhje me gjyqtarët, *Camelia Bogdan*, § 70, dhe *Juszczyzsyn*, § 236, të dy cituar më sipër). Urdhrat mbështeteshin në faktin se ndaj tyre ishte në proces një hetim penal për një “krim të rëndë të kryer me dashje”, dhe për faktin se ndaj tyre ishin ngritur akuza. Pezullimi ishte i detyrueshëm sapo një magjistrat merrte statusin e të pandehurit në një hetim penal për veprën penale përkatëse dhe vijonte deri në përfundimin e procesit penal apo me shpalljen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë (shih paragrafin 25 më sipër).

50. Hetimi dhe akuzat penale kishin të bënin me pretendimin për sjellje të pahijshme, në lidhje me deklaratimet e bëra në procesin e rivlerësimit të asaj periudhe, në lidhje me kërkuesen e parë, më konkretisht në kontekstin e vlerësimit të pasurisë së saj dhe të bashkëshortit të saj (kërkuesi i dytë), ku që të dy ishin zyrtarë publikë që i nënshtroheshin detyrimit për deklaram. Pretendimi për sjellje të pahijshme lidhej me detyrimet e tyre ligjore për përshtatshmëri financiare në marrëdhënien e tyre martesore dhe në veprimet me të tjerët. Kërkuesit nuk argumentuan nëse e drejta e tyre për respektimin e jetës familjare ishte në rrezik. Për sa i përket së drejtës për respektimin e “jetës private”, Gjykata nuk vlerëson se arsyet e vërteta për urdhrat e pezullimit lidheshin me jetën private të kërkuesve pasi ato lidheshin me çështje që kishin të bënin me integritetin e tyre financiar si zyrtarë publikë dhe me respektimin nga ana e tyre e së drejtës penale (krahaso *Smith dhe Grady kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33985/96 dhe 33986/96 § 71, GJEDNJ 1999-VI; *Özpinar kundër Turqisë*, nr. 20999/04, §§ 43 dhe 47, 19 tetor 2010; dhe *Sodan kundër Turqisë*, nr. 18650/05, §§ 47–49, 2 shkurt 2016). Mbetet për t’u vlerësuar nëse qasja e mbështetur në pasoja do të kërkojë që problematika të shqyrtohet nën nenin 8 të Konventës për çështjen konkrete (krahaso *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 362 për pasojat për jetën private në lidhje me shkarkimin nga detyra në procesin e rivlerësimit).

51. Në muajin nëntor 2018, Gjykata Administrative e Apelit, si gjykatë e shkallës së parë për këtë çështje, gjykoi se urdhrat e pezullimit nuk ishin në përputhje me ligjin shqiptar. Gjykata vëren se gjetjet e asaj gjykate: i. se pezullimi sipas nenit 151 të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve mund të lidhej vetëm me “një krim të rëndë të kryer me dashje”; dhe ii. se vepra sipas nenit 257/a të Kodit Penal për të cilën akuzoheshin kërkuesit ishte jashtë fushës së veprimit të atij nocioni sipas ligjit shqiptar. Çështja kishte të bënte me interpretimin e një dispozite të re të legjislationit që kishte qenë në fuqi që prej vitit 2016. Gjithashtu, ai ligj zbatohet në një situatë ku procesi i rivlerësimit ishte në vijim. Rezulton se interpretimi i gjykatës për ligjin nuk kishte avantazhin e të qenit i gjykuar më herët përpara Gjykatës së Lartë (shih *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, §§ 23–29, 12 tetor 2021). Gjykata thekson, në lidhje me këtë aspekt, se roli i gjykimit që u vishet gjykatave shërben për të hequr dyshimet në lidhje me interpretimet; do të vijë një ditë kur një normë ligjore e caktuar do të zbatohet për herë të parë (shih *mutatis mutandis, Selabattin Demirtaş kundër Turqisë* (nr. 2) [DHM], nr. 14305/17, §§ 250 dhe 253, 22 dhjetor 2020).

52. Fillimisht u takon autoriteteve vendëse, që do të thotë gjykatave, të interpretojnë dhe zbatojnë ligjin vendës (*ibid.*, § 249). Në lidhje me klasifikimin vendës të veprës penale, Gjykata thekson edhe vendimet e saj për qëllimet legjitime të ndjekura, veçanërisht në procesin e rivlerësimit në Shqipëri, si

edhe për detyrimet ligjore përkatëse për prokurorët, si detyrimi për të dhënë një deklaram të plotë dhe të vërtetë të pasurisë (krahaso *Wypych kundër Polonisë* (vendim), nr. 2428/05, 24 tetor 2005) dhe, sipas interpretimit, detyrimi për nevojën për masa proporcionale me qëllim respektimin e detyrimeve, duke përfshirë përgjegjësitë disiplinore apo përgjegjësi të tjera për shkelje të rënda që kanë të bëjnë me mosrespektimin e tyre (shih *Xboxhaj* cituar më sipër, § 221).

53. Vendimi për të nisur një hetim penal dhe për të akuzuar kërkuesit, që nuk është kundërshtuar në mënyrë specifike përpara Gjykatës, sipas nenit 8 të Konventës, si edhe pezullimi i tyre si rezultat i atij vendimi, u bënë objekt i një mbulimi disi të gjerë në medien *online* (shih paragrafin 19 më sipër). Në sytë e të paktën disa qytetarëve të shoqërisë, mund të jetë venë në pikëpyetje aftësia e kërkuesve për të vijuar të kryenin funksionet e tyre si prokurorë. Urdhrat e pezullimit, edhe pse në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, mund të ndikonin në mënyrë të parikuperueshme në reputacionin e tyre profesional në sytë e publikut. Në të njëjtën kohë, ata kishin të drejtën për prezumimin e pafajësisë. Edhe pse situata e të ardhurave të kërkuesve nuk ndryshoi në mënyrë të ndjeshme dhe “rrethi i tyre i brendshëm” nuk u ndikua nga kjo situatë, pezullimi i privoi ata nga mundësia për të vijuar profesionin e tyre dhe për të jetuar në mjedisin profesional ku ata do të mund të ndiqnin qëllimet e tyre për zhvillim profesional dhe personal (shih *Juszczyzsyn*, cituar më sipër, § 235, dhe *Gumenyuk dhe të Tjerë kundër Ukrainës*, nr. 11423/19, § 88, 22 Korrik 2021).

54. Gjithashtu, theksohet se sipas vendimit të datës 8 nëntor 2018, kërkuesit i morën kostot e tyre nga Prokuroria e Përgjithshme.

55. Në këtë pikë, Gjykata vendos se pavarësisht rrethanave të caktuara të specifikuara më sipër, situata e kërkuesve ndryshon për sa i përket pranueshmërisë së kërkesës në mbështetje të nenit 8 të Konventës.

i) Zbatueshmëria e nenit 8 të Konventës

a) Kërkuesja e parë

56. Kërkueses së parë iu ndalua të ushtronte detyrat e saj si prokurore në kontekstin e hetimeve penale, nga data 11 maj deri më 25 korrik 2018, kur KPK-ja shpalli vendimin për ta shkarkuar nga detyra dhe ajo u pezullua *ex lege* në mbështetje të nenit 62(1) të Ligjit për Rivlerësimin. Palët nuk argumentuan midis tyre faktin se ndikimi negativ ndaj “jetës së saj private” pas urdhrit të pushimit dhënë nga Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm nuk vihej më në dyshim pas vendimit të KPK-së në procesin e rivlerësimit. Për këtë arsye, “ndërhyrja” zgjati dy muaj e gjysmë. Nuk pati kundërshtime për faktin se gjatë asaj periudhe ajo vijoi të merrte pagën e saj (shih paragrafin 27 më sipër).

57. Në lidhje me argumentin e kërkueses së parë se pezullimi kishte një ndikim ndërhyrës në procesin e rivlerësimit dhe pati shumë ndikim në vendimin e KPK-së për ta shkarkuar nga detyra, Gjykata vëren se ajo nuk e provoi atë argument, përtej faktit se pezullimi, faktikisht, ishte përmendur në përcaktimin e statusit të saj të punësimit në atë periudhë.

58. Gjykata thekson, se sipas qasjes së mbështetur në pasoja, një kërkues duhet të paraqesë prova për të vërtetuar pasojat e masës së kundërshtuar, dhe se ato pasoja duhet të jenë shumë të rënda dhe të kenë ndikim në jetën e tij apo saj private në një masë shumë të rëndë (shih *Denisov*, cituar më sipër, § 116). Gjykata vlerëson se kërkuesja e parë nuk ka demonstruar se pasojat negative si rezultat i urdhrit të pezullimit ishin mjaftueshëm të rënda për të vënë në rrezik të drejtën e saj për respektimin e jetës private sipas nenit 8 të Konventës (shih *Camelia Bogdan*, cituar më sipër, § 86; *Miroslava Todorova kundër Bullgarisë*, nr. 40072/13, §§136-45, 19 tetor 2021; dhe *J.B. dhe të Tjerët kundër Hungarisë* (vendim), nr. 45434/12 dhe 2 të tjerë, §§ 130-38, 27 nëntor 2018). Çdo ndikim tjetër negativ, për shembull në reputacion, kryesisht erdhi si pasojë e faktit se ajo ishte akuzuar për një vepër penale më shumë sesa nga pezullimi *ex lege*, pavarësisht faktit se i është dhënë paga. Rrjedhimisht, ankesa e saj nuk përputhet *ratione materiae* me parashikimet e Konventës sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 4.

b) Kërkuesi i dytë

59. Kërkuesi i dytë u pezullua nga data 11 maj deri më 8 nëntor 2018. Vendimi i shpallur në një datë të mëvonshme në atë periudhë, nuk hyri në fuqi për të, pa pasur ndonjë arsye të qartë, deri në janar 2020 – një periudhë e konsiderueshme, duke pasur parasysh natyrën e çështjes në lidhje me punësimin. Qeveria nuk ka provuar se përse përfshirja e KLP-së, sipas ligjit shqiptar, ishte e domosdoshme për të vënë në zbatim vendimin (shih paragrafët 14–16 më sipër). Rezulton se nuk ka asnjë indicie që të provojë nëse u mor ndonjë vendim për këtë aspekt. Duke qenë se Gjykata Administrative e Apelit veptoi si gjykatë e shkallës së parë për çështjen, ekziston mundësia që të drejtohet pyetja, nëse vendimi i saj ishte i formës së prerë. Megjithatë, Qeveria nuk ka paraqitur argumente për këtë aspekt. Kërkuesi i dytë u pengua në mënyrë të pajustificueshme që të përfitonte nga rezultati i procesit të tij duke rimarrë pozicionin e tij zyrtar. Pra, atij i ishte ndaluar të ushtronte detyrën e tij zyrtare për më shumë se njëzet muaj.

60. Është e rëndësishme të theksohet se, gjatë asaj periudhe, situata për të cilën u bë një ankesë, vijoi edhe pasi procesi penal ndaj kërkuesit të dytë kishte përfunduar nga një gjykatë në muajin prill 2019 (krahaso *Gumenyuk dhe të Tjerë*, cituar më sipër, § 88). Atij vazhdoi t'i privohej mundësia për të rimarrë detyrën e tij zyrtare dhe për të jetuar në mjedisin profesional ku ai do të mund të ndiqte qëllimet e tij për zhvillim profesional dhe personal (shih *Juszyzysyn*, § 235 dhe *Gumenyuk dhe të Tjerë*, § 88, të dy cituar më sipër). Vonesa në ekzekutimin e vendimit në favor të tij duhet të ketë pasur ndikim në pasigurinë e pozicionit të tij.

61. Duke marrë në konsideratë zhvillimet në procesin vendës, Gjykata vlerëson se kërkuesi i dytë ka vërtetuar se pasojat negative ishin mjaftueshëm të rënda për të vënë në rrezik të drejtën e tij për respektim të jetës private sipas të nenit 8 të Konventës. Gjithashtu, Gjykata gjykon se, për sa i përket kësaj kërkese, ai nuk e ka humbur statusin e tij të viktimës.

ii. Shterimi i mjeteve vendëse nga kërkuesi i dytë

62. Gjithashtu, Qeveria argumentoi se përpara depozitimit të ankesës pranë Gjykatës në qershor 2018, kërkuesit nuk kishin shteruar mjetet vendëse duke e paraqitur çështjen përpara Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata nuk përjashton mundësinë e ekzistencës së disa pasigurive në atë periudhë për rrugën specifike gjyqësore për të kontestuar një urdhër pezullimi (shih paragrafët 20, 26, 28 dhe 29 më sipër), veçanërisht në lidhje me faktin se urdhri i pezullimit u referua – siç rezultoi më pas në mënyrë të gabuar – për apelim pranë KPA-së si mjeti i duhur (shih paragrafin 11 më sipër). Sidoqoftë, kërkuesi i dytë e shteroi mjetin e përmendur nga Qeveria, menjëherë pasi paraqiti ankesën pranë Gjykatës dhe pasi ngriti argumentet për mungesën e një mjeti efektiv (shih paragrafin 80 më poshtë). Në këto rrethana dhe në statusin aktual të çështjes kur pranueshmëria e ankesës po shqyrtohet pas zhvillimeve vendëse, Gjykata nuk është e gatshme ta rrëzojë për mosshkrim të mjeteve vendëse (krahaso *Delijorgji kundër Shqipërisë*, nr. 6858/11, § 55, 28 prill 2015). Në këtë mënyrë, kundërshtimi i Qeverisë rrëzohet.

iii. Përfundim

63. Gjykata arrin në përfundimin se ankesa e kërkueses së parë është e papranueshme *ratione materiae*.

64. Në vijim, ajo vëren se ankesa e kërkuesit të dytë nuk është as qartazi e pambështetur në fakte dhe as e papranueshme për ndonjë nga arsyet e listuara në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohej e pranueshme.

B. Meritat

65. Në lidhje me gjetjet në paragrafët 59–61 më sipër, Gjykata gjykon se ka pasur një “ndërhyrje” në të drejtën e kërkuesit të dytë për respektim të jetës së tij private në mbështetje të nenit 8 të Konventës për pezullimin e tij nga Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm nga ushtrimi i detyrave të tij si prokuror.

66. Një ndërhyrje e tillë është në shkelje me nenin 8, me përjashtim të rastit kur justifikohet sipas paragrafit 2 të asaj dispozite si një ndërhyrje “në përputhje me ligjin” në respektim të një ose më shumë qëllimeve legjitime të listuara në të dhe si “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për t’i përmbushur ato qëllime (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 378).

67. Shprehja “në përputhje me ligjin” kërkon që masa e kundërshtuar të jetë në respektim të shtetit të së drejtës (shih *Selahattin Demirtaş*, cituar më sipër, § 249). Anëtarët e gjyqësorit duhet të gëzojnë – ashtu si edhe qytetarët e tjerë – mbrojtjen nga arbitrariteti në pushtetin ekzekutiv (shih *Grzegda kundër Polonisë*, [DHM], nr. 43572/18, § 327, 15 Mars 2022, dhe *Kövesi kundër Rumanisë*, nr. 3594/19, § 124, 5 maj 2020).

68. Gjykata vëren se pezullimi *ex lege* i kërkuesit të dytë nga data 11 maj 2018 e në vijim u mbështet në faktin se ndaj tij po zhvillohej një hetim që ishte në proces për një “krim të rëndë të kryer me qëllim”. Nga materiali në dispozicion rezulton se koncepti ngrinte një çështje interpretimi për një dispozitë të re në legjislacionin shqiptar (shih paragrafin 12 dhe 51 më sipër), kryesisht për faktin se çfarë përbënte një “krim të rëndë” për qëllimet përkatëse. Gjithashtu, vërehet se neni 151 i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve parashikonte se një pezullim *ex lege* do të zbatohet deri në përfundimin e procesit penal ose deri në shpalljen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë në çështjen penale. Sipas interpretimit, sa më shumë të zgjaste pezullimi, aq më të rënda ishin pasojat si për jetën private të personit dhe me shumë mundësi edhe për shtetin e së drejtës. Gjithashtu, Gjykata tashmë është shprehur se rezultonte të ekzistonte një pasiguri në periudhën përkatëse, në lidhje me rrugën e duhur juridike për apelimin e një pezullimi *ex lege*, si edhe për zbatimin e menjëhershëm të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelimeve në favor të një magjistrati. Rezulton se apelimi i Prokurorit të Përgjithshëm ndaj vendimit të gjykatës në çështjen e kërkuesve është ende pezull pranë Gjykatës së Lartë.

69. Rezulton se në periudhën nga data 18 prill 2019, datë kur Gjykata e Apelit Vlorë konfirmoi përfundimin e hetimit penal ndaj kërkuesve, deri më janar 2020, kur kërkuesi i dytë u rikthye në detyrën e tij si prokuror, Gjykata konstaton se pezullimi i vijuar i kërkuesit të dytë nuk kishte asnjë bazë ligjore pasi ndaj tij nuk ekzistonte më një hetim penal (shih paragrafët 25, 59 dhe 60 më sipër). Qeveria nuk i është referuar ndonjë baze tjetër ligjore për vijimësinë e ndalimit të tij nga rimarrja e detyrës si prokuror.

70. Për sa më sipër, Gjykata nuk gjykon se ndërhyrja ishte “në përputhje me ligjin”, të paktën për sa i përket periudhës pas datës 18 prill 2019.

71. Për këtë arsye, në lidhje me kërkuesin e dytë, është shkelur neni 8 i Konventës.

IV. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS PËR DHËNIEN E DOKUMENTEVE MEDIËS

72. Kërkuesja e parë pretendonte se dokumente të caktuar i ishin dhënë medias në shkelje të nenit 8 të Konventës (cituar më sipër).

A. Parashtrimet e palëve

73. Qeveria argumentoi se kërkuesja e parë nuk kishte shteruar mjetet vendëse, duke depozituar një ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ose duke bërë një padë civile për kompensimin e dëmeve shkaktuar nga shkeljet e autoriteteve. Nuk kishte pasur ndërhyrje sipas nenit 8 të Konventës, pasi nuk ishte bërë asnjë deklaram i paligjshëm nga një autoritet ose zyrtar publik – publikimi/et *online* nuk përmbanin asnjë informacion që ishte konfidencial ose i paaksesueshëm për publikun e gjerë me anë të mjeteve të tjera. Kërkuesja nuk kishte kundërshtuar apo ishte ankuar kurrë se deklarami i saj i pasurisë ishte bërë publik, duke u fokusuar te bërja publike e informacioneve ose dokumenteve në lidhje me kunatin dhe babanë e saj. Këto dokumente nuk ishin depozituar në KPK nga kërkuesja, dhe për çdo rast, ishin lehtësisht të aksesueshme nga publiku.

74. Kërkuesja e parë argumentoi se Qeveria nuk kishte provuar se një ankesë ose padi civile mbështetur në pretendimin për publikim të paligjshëm gjatë gjykimit në procesin e rivlerësimit do të kishte mundësi për sukses. Identiteti i personit përgjegjës për dëmin e pretenduar do të duhej të bëhej publik. Sidoqoftë, kërkuesja vazhdimisht u kishte kërkuar organeve të përfshira në rivlerësim (OMN, KPK dhe ILDKPKI) që të hetonin rrjedhjen e informacionit.

B. Vlerësimi i Gjykatës

75. Qëllimi i një çështje referuar në Gjykatë sipas interpretimit të nenit 32 të Konventës në ushtrimin e së drejtës për një kërkesë individuale përcaktohet nga ankesa e kërkuesit. Një ankesë përbëhet nga pretendimet faktike dhe argumentet ligjore. Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj mbi fakte që nuk përfshihen në ankesë dhe të gjykojë përtej qëllimit të një çështje, që do të thotë, për aspekte që nuk janë referuar në të (shih *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, § 126, 20 mars 2018). Edhe nëse Qeveria, në parashtrimet e saj, nuk ka bërë kërkesë për papranueshmëri – në lidhje me ankesën specifike – për sa i përket respektimit të rregullit për afatin gjashtëmujor (në zbatim në periudhën konkrete), nuk i takon Gjykatës ta përjashtojë kërkesën vetëm për këtë rregull, pasi nuk është bërë një kundërshtim paraprak për këtë aspekt (*ibid.*, § 138). Ankesa e kërkuesit duhet të përmbajë të gjitha parametrat e nevojshëm në mënyrë që Gjykata të përcaktojë problematikën që do t'i kërkohej të shqyrtojë, ashtu siç duhet të veprojë edhe Qeveria, nëse Gjykata vendos që ta ftojë të paraqesë parashtrimet e saj për pranueshmërinë dhe/ose meritat e çështjes (shih *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, § 104, 6 nëntor 2018, në kontekstin e nenit 6 të Konventës).

76. Gjykata vëren se në kërkesën e depozituar në muajin qershor 2018, kërkuesit parashtronin, se “informacioni konfidencial [ishte] publikuar në Alpenews”, duke iu referuar, dhe bashkëlidhur, një artikull publikuar më 9 mars 2018 (shih paragrafin 18 më sipër). Gjithashtu, ata parashtronin se “ishin ndjekur nga një fushatë e pamëshirshme në media kundër [kërkueses së parë], duke e sulmuar atë hapur me anë të një interpretimi arbitrar dhe selektiv të informacioneve për pasurinë e saj”. Në vijim, ankesa përkatëse u formulua si më poshtë: “rrjedhja e informacionit konfidencial depozituar pranë KPK-së në kontekstin e procesit të rivlerësimit shkakton [shkaktoi] një ndërhyrje të paligjshme dhe joproporcionale me të drejtën e [kërkueses së parë] për privatësi në mbështetje të nenit 8 të Konventës. Veçanërisht... informacioni konfidencial në lidhje me pasuritë [që ishin] publikuar në Alpenews... Publikimi [ishte] pasuar me një fushatë të pamëshirshme në medie ndaj [saj].”

77. Për sa ka të bëjë me artikullin e referuar, ai nuk bënte publik asnjë dokument apo material në lidhje me kërkuesen e parë, përveç tekstit të cituar në paragrafin 18 më sipër. Nuk është provuar se, për sa i përket ankesës së kërkueses së parë për atë artikull, ka pasur ndonjë “ndërhyrje” në ndonjë aspekt të Shtetit përgjegjës, më konkretisht në lidhje me aksesin e paautorizuar të – dhe/ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme ose transmetimin e – ndonjë dokument specifik konfidencial i depozituar ose marrë në procesin e rivlerësimit (krahaso *Cășuneanu kundër Rumanisë*, nr. 22018/10, §§ 83–84, dhe 97, 16 prill 2013, dhe *M.D. dhe të Tjerët kundër Spanjës*, nr. 36584/17, § 65, 28 qershor 2022). Nuk provohet se artikulli përmbante ndonjë informacion sensitiv në lidhje me kërkuesen e parë apo pasuritë e saj. Në këtë mënyrë, ankesa e depozituar nuk pajtohet *ratione personae* me parashikimet e Konventës sipas nenit 35 § 3 (a) dhe duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35 § 4.

78. Në lidhje me bërjen publike të dokumenteve shtesë në media dhe një fushatë mediatike nga muaji mars deri në korrik 2018, për arsyet e mëposhtme, Gjykata nuk ka nevojë të përcaktojë nëse janë shteruar mjetet vendëse. Pretendimet faktike nuk ishin as të detajuara dhe as të provuara në kërkesë. Vetëm në muajin prill 2019, në parashtrimet e tyre si përgjigje ndaj parashtrimeve të Qeverisë, kërkuesit (kryesisht, kërkuesja e parë) paraqitën “thelbin e ankesës” (siç shpreheshin ata), duke artikuluar elementet thelbësore faktike, duke cituar shembuj specifikë të artikujve të tjerë, disa

prej të cilëve pretendoheshin se mbështeteshin në, ose ishin riprodhuar nga, kopje të dokumenteve që kishin rrjedhur, si edhe paraqitën kopje të këtyre artikujve. Në të njëjtat parashtrime, kërkuesit argumentuan, për herë të parë, se mediat kishin publikuar informacione konfidenciale në vitin 2018, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e tyre, sipas nenit 8 të Konventës. Kjo ankesë shkonte për një ose disa medie private që kishin publikuar informacionin për të cilin ankoheshin kërkuesit. Gjykata konstaton se ankesa e sipërpërmendur u depozitua në muajin prill 2019. Kërkuesit nuk kanë specifikuar nëse ankesa i ishte nënshtuar ndonjë procesi vendës gjatë kohëve të fundit sipas afatit gjashtëmujor, për shembull, në lidhje me medien ose pronarëve të saj apo zyrtarëve publikë (shih paragrafin 19 më sipër). Ankesa u depozitua përtej afatit dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës, në fuqi në periudhën konkrete.

79. Së fundmi, në vërejtjet e tyre, kërkuesja e parë aludoi edhe për një çështje tjetër në lidhje me një fakt të njëkohësishëm, më konkretisht shpërndarjen dhe publikimin në muajin prill 2019 të një raportit konfidencial për kontrollin mbi figurën të lëshuar gjatë procesit të rivlerësimit. Gjykata gjykon se ky parashtrim nuk është një detajim i ankesës fillestare dhe se është jashtë qëllimit të çështjes përpara saj (shih *Denis dhe Irvine kundër Belgjikës* [DHM], nr. 62819/17 dhe 63921/17, §§ 101-02 dhe 110-11, 1 qershor 2021, dhe *Antonyuk*, cituar më sipër, § 94). Gjykata gjykon se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ky parashtrim në çështjen konkrete.

V. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 13 TË KONVENTËS

80. Në muajin qershor 2018, kërkuesit u ankuan se, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës, ata nuk kishin pasur mjete efektive për ankesën e tyre sipas nenit 8 të Konventës, në lidhje me urdhrat e pezullimit. Pasi shqyrtoi parashtrimet e palëve dhe në mbështetje të konstatimeve të Gjykatës, në paragrafët 41 dhe 63 më sipër, ankesa bërë në mbështetje të nenit 13 është e papranueshme sipas nenit 35 § 3 (a) të Konventës, dhe për këtë arsye duhet të rrëzohet sipas nenit 35 § 4 në lidhje me kërkuesen e parë. Sipas konstatimeve në paragrafin 71 më sipër, kjo ankesë nuk është e nevojshme të shqyrtohet për kërkuesin e dytë.

VI. PRETENDIME PËR SHKELJE TË TJERA TË KONVENTËS

81. Në parashtrimet e tyre, kërkuesit pretenduan si më poshtë.

a) Shteti përgjegjës nuk kishte informuar Gjykatën për rezultatin e apelimit në lidhje me vendimin e datës 8 nëntor 2018. Sipas të gjitha materialeve në zotërimin e saj (shih edhe paragrafët 12, 14 dhe 16 më sipër), Gjykata gjykon se Shteti përgjegjës ka respektuar detyrimin e tij sipas nenit 38 të Konventës.

b) “Zinxhiri i zhvillimeve që çuan” në pezullimin e tyre nga detyra shkaktoi një sulm të motivuar politikisht, në kundërshtim me nenin 18 të Konventës. Duke iu referuar praktikës gjyqësore përkatëse (shih *Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], nr. 72508/13, § 291, 28 nëntor 2017, dhe *Navalnyy kundër Rusisë* [DHM], nr. 29580/12 dhe 4 të tjerë, § 154 e në vijim, 15 nëntor 2018) dhe sipas të gjitha materialeve në zotërimin e saj, dhe për aq sa problematikat në ankesë janë nën kompetencën e saj (shih edhe paragrafët 41 dhe 63 më sipër), Gjykata vendos se kjo ankesë është e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

c) Edhe shkarkimi i kërkueses së parë nga detyra në procesin e rivlerësimit solli një sulm të motivuar politikisht në kundërshtim me nenin 18 të Konventës. Gjykata vëren se ankesat në lidhje me vendimet e datës 25 korrik 2018 dhe 29 maj 2019 nuk ishin pjesë e çështjes komunikuar Qeverisë përgjegjëse. Kërkuesja e parë ka depozituar kërkesa të veçanta në mbështetje të Rregullit 47 § 1 të Rregullores së Gjykatës të interpretuar së bashku me Drejtimin e Praktikës për Nisjen e Proceseve (veçanërisht paragrafët 1–5). Këto kërkesa janë pezull në Gjykatë. Për këtë arsye, nuk është e nevojshme që këto parashtrime të shqyrtohen në çështjen konkrete.

VII. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

82. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjeshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. DËMSHPËRBLIMI

83. Kërkuesi i dytë kërkoi 200,000 euro për dëmin jopasuror dhe 1,350 euro për dëmin pasuror për uljen e tij në detyrë në vitin 2018.

84. Qeveria i kundërshtoi pretendimet, duke argumentuar *inter alia*, se kërkuesi i dytë nuk kishte paraqitur një padi civile për dëmshpërblim.

85. Gjykata nuk konstaton ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmshpërblimit pasuror të pretenduar; për këtë arsye, ajo e rrëzon këtë pretendim. Gjykata ka kompetencën t'i akordojë palës së dëmtuar një kompensim të tillë për aq sa ajo e gjykon të përshtatshme, sipas nenit 41 të Konventës, nëse ligji vendës nuk lejon – ose lejon vetëm pjesërisht – që të bëhet korrigjim. Në të njëjtën kohë, rregulli për shterimin e mjeteve vendëse, sipas nenit 35 § 1, nuk zbatohet për shpërblim të drejtë sipas nenit 41 (shih *Nagmetov kundër Rasisë* [DHM], nr. 35589/08, § 66, 30 mars 2017, dhe *Tërshana kundër Shqipërisë*, nr. 48756/14, § 176, 4 gusht 2020). Gjykata i akordon kërkuesit të dytë 4,500 euro për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund të ishte e tarifueshme.

B. Kostot dhe shpenzimet

86. Kërkuesi i dytë, së bashku me kërkuesen e parë, kërkuan 57,608 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra për çështjen pranë Gjykatës (shih paragrafët 34, 45, 72 dhe 80 më sipër) dhe për depozitim dhe parashtrimeve të mëtejshme (shih paragrafët 78–79 dhe 81 më sipër).

87. Qeveria e kundërshtoi pretendimin.

88. Një kërkues ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm për aq sa është provuar se këto kosto dhe shpenzime janë bërë në të vërtetë dhe kanë qenë të nevojshme dhe janë të arsyeshme për kuantin. Janë marrë në konsideratë dokumentet në zotërimin e saj dhe kriteret e mësipërme, dhe për aq sa pretendimi është i lidhur me një ankesë të pranueshme që ka të bëjë me konstatimin e një shkelje për kërkuesin e dytë (shih *Bici kundër Shqipërisë*, nr. 5250/07, § 59, 3 dhjetor 2015), Gjykata e vlerëson të arsyeshme që t'i akordojë 3,000 euro, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet atij.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA:

1. *E deklaron*, unanimisht, të pranueshme ankesën e kërkuesit të dytë në lidhje me pezullimin e tij nga detyra në mbështetje të nenit 8 të Konventës;

2. *I deklaron*, me shumicë, të papranueshme ankesat e kërkueses së parë në mbështetje të nenit 8 dhe 13, dhe ankesat e të dy kërkuesve në mbështetje të neneve 6 dhe 18 të Konventës;

3. *Gjykon*, unanimisht, se është shkelur neni 8 i Konventës për kërkuesin e dytë;

4. *Gjykon*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se Shteti përgjegjës ka përmbushur detyrimin e tij në mbështetje të nenit 38 të Konventës;

5. *Gjykon*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se nuk është e nevojshme të shqyrtojë ankesën e kërkuesit të dytë në mbështetje të nenit 13 të Konventës dhe parashtrimet shtesë të kërkuesve;

6. *Gjykon*, në mënyrë unanime,

a) se Shteti përgjegjës duhet t'i paguajë kërkuesit të dytë, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që do të konvertohen në monedhën e Shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:

i. 4,500 euro (katër mijë e pesëqind euro) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme, për dëmin j pasuror;

ii. 3,000 euro (tre mijë euro) plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit të dytë, për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i afatit tremujor përmendur më sipër deri në shlyerje, për shumat e mësipërme do të paguhet interes i thjeshtë në normën e barasvlershme me normën marginale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre për qind pikë;

c) *Rrëzohet*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, pjesën tjetër të kërkesës për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 4 prill 2023, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

MILAN BLAŠKO PERE PASTOR VILANOVA

Regjistrar Kryetar

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, opinioni i ndarë i Gjyqtarit Serghides paraqitet në një shtojcë në këtë vendim.

P.P.V

M.B

OPINIONI PJESËRISHT KUNDËRSHTUES I GJYQTARIT SERGHIDES

1. Unë jam dakord me pikën 1 të masave operative të vendimit ku gjykohet se ankesa e kërkuarit të dytë bërë në përputhje me nenin 8 të Konventës, në lidhje me pezullimin e tij nga detyra është e pranueshme dhe, gjithashtu, jam dakord me pikën 3 të masave operative për faktin se është shkelur neni 8 i Konventës për pezullimin nga detyra të kërkuarit të dytë. Gjithashtu, jam dakord me paragrafin 6 të masave operative në lidhje me akordimet për dëmin jopasuror dhe kostot dhe shpenzimet.

2. Megjithatë, unë nuk jam dakord me paragrafin 2 të masave operative të vendimit ku gjykohet se ankesat e kërkuarës së parë bërë në mbështetje të neneve 8 dhe 13, dhe ankesat e të dy kërkuarëve bërë në mbështetje të neneve 6 dhe 18 të Konventës, janë të papranueshme. Gjithashtu, unë nuk jam dakord me paragrafët 4, 5 dhe 7 të masave operative të vendimit.

3. Në lidhje me paragrafët 2, 4, 5 dhe 7 të masave operative të vendimit, në vend që të jap një opinion të veçantë të plotë apo të votoj në mënyrë anonime ndaj atyre paragrafëve, kam zgjedhur të bashkëlidh këtë “deklaratë të thjeshtë kundërshtuese”, një deklaratë e thjeshtë mosdakordësimi me një pjesë të vendimit, një nga mënyrat e të shprehurit të kundërshtimit të cilën gjyqtarët kanë të drejtë ta përdorin në mbështetje të Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës.